



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 2.3, dhe nenit 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, nenit 16 paragrafi 9 të Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, nenit 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA REZERVË- 38 NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE INVESTIME KAPITALE (burimi i financimit 10)

Neni 1

Mjetet buxhetore nga kategoria rezervë-38, burimi i financimit 10, në kuadër të buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021, në shumë totale 380,930.00 €,

Transferohen në kategorinë e shpenzimeve Investime Kapitale, në nën-programet si vijon:

- **Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ (66030)**, kodi i projektit 47657 – Ndërtimi, shtimi, rritja dhe mirëmbajtja (në pronën publike të qytetit), e parqeve, hapësirave të reja të gjelbëruara, kopshteve të hapura me lodra për fëmijë, etj., në vlerë prej.....**80,000 €**
- **Shërbimet e shëndetësisë primare (73300)**, kodi i projektit- 47717- Ndërtimi i objektit të QMF 3 – në Podujevë, në vlerë prej..... **100,930 €**
- **Administrata e Shëndetësisë (73014)**, kodi i projektit- 49432- Ndërtimi i shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në vlerë prej.....**100,000 €**
- **Arsimin Para fillor dhe Çerdhe (92290)**, kodi- (Projekt i ri)- Ndërtimi, i objektit të çerdes në qytet afër shkollës “Fan S. Noli”, në vlerë prej..... **100,000 €**

Neni 2

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-400/03-0035827/21
Podujevë, 29 prill 2021

